




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Indeksi i Çmimeve të Importit TM1 - 2018



Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) gjegjësisht Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare ka filluar të publikojë Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) në qershor 2009. Çmimet e importit filluan të mblidhen në fillim të 2006. Çmimet mblidhen në bazë tremujore dhe mbulojnë kompanitë më reprezentative të importit të cilat ishin aktive në shumicën e komunave për periudhën tremujori i parë 2006 – tremujori i parë 2018.

Publikimi përmban tabelën e Indeksit të Çmimeve të Importit në Kosovë në bazë tremujore, T1 2006 –T1 2018, mesatarja vjetore për 2006 - 2018 (2010 = 100) me ndryshime tremujore dhe vjetore në përqindje, me prezantim grafikonesh, tabela për pesha, indeksin tremujor për T1 2018, ndryshimet tremujore (T4 2017 –T1 2018) dhe ndryshimet vjetore (T1 2017 –T1 2018) për sektorët sipas Sistemit të Harmonizuar.

IÇIMP është përgatitur në përputhje me standardet dhe metodologjitë evropiane dhe në bashkëpunim me ekspertët nga Statistika e Suedisë dhe Agjencioni Suedez i Zhvillimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA).IÇIMP është në zhvillim e sipër dhe në të ardhmën do të shtohen më shumë vrojtme të çmimeve.

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato të dërgohen në adresën elektronike: ekonomik@ks-gov.net

Ky publikim është përgatitur nga:

Ilir T. Berisha - Drejtori i Departamentit
Ibish Asllani - Shef divizioni
Hamdi Jupolli - Shef Sektori

Qershor, 2018

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së,
Isa Krasniqi

Simbolet dhe Shkurtesat

IÇIMP	Indeksi i Çmimeve të Importit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
OBD	Organizata Botrore e Doganave
TM1	Tremujori i parë
TM2	Tremujori i dytë
TM3	Tremujori i tretë
TM4	Tremujori i katërt
:	Shifra nuk është disponibël
0	Më pak se gjysma e njësisë së përdorur
-	Nuk aplikohet
%	Përqindje
W	Ponderët statistikor (pesha specifike)
∅	Mesatare

Përmbajtja

Faqe

Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) për tremujorin e parë 2018	4
Tabela 1:Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) TM1 2006–TM4 2017 (2010 = 100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje	5
Tabela 1 vazhdim:Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) TM1 2006–TM4 2017 (2010 = 100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje	6
Figura 1: Zhvillimi i IÇIMP, TM1 2006 – TM1 2018 (2010=100)	7
Tabela 2: Peshat, numrat e Indeksi, ndryshimet mujore dhe vjetore në përqindje sipas sektorëve të Sistemit të Harmonizuar	8
Metodologjia	9.10

Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) për tremujorin e parë 2018

Indeksi i tërsishem i çmimeve të importit në Kosovë është i pa ndryshuar 0.0 % në TM1 2018 krahasuar me TM4 2017. Krahasuar me TM1 2017 çmimet e importit u ngriten në një mesatare prej 1.4 %.

Tremujori i katërt 2017 – Tremujori i parë 2018 0.0 %

Përkundër mos ndryshimit të indeksit të çmimeve të importit në TM1-2018 krahasuar me TM4 2017 vërehen disa rënje të çmimeve të disa sektore. Rënje më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin të këpucet (-13.0 %), produktet bimore (-5.0 %), lekura dhe artikujt e saj (-4.2 %), shtazet e gjalla; produktet e shtazëve (-3.7 %), vajrat ushqyese (-1.1 %), paisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (-0.9 %), artikujt ushqimor të përgaditur, pijet dhe duhani (-0.8 %), instrumentet optike, fotografik, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës (-0.8 %), produktet e industrive kimike (-0.6 %) dhe druri dhe artikujt e drurit (-0.5 %).

Rënja u neutralizua kryesisht nga ngritja e çmimeve sipas sektoreve të metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (3.3 %), plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (2.6 %), tekstili dhe artikujt e tekstilit (2.0 %), produktet minerale (1.5 %), artikujt e gurit, llaçit, produktet e keramikës dhe të qelqit (1.2 %), artikujt e ndryshem të prodhuar (0.1 %) dhe letrat dhe artikujt e saj (0.1 %).

Tremujori i parë 2017 - Tremujori i parë 2018 1.4 %

Çmimet e Importit në Kosovë u ngriten në një mesatare prej 1.4 % në mes TM1 2017 dhe TM1 2018. Ngritje më të mëdha sipas sektorëve ishin të metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (12.3 %), tekstili dhe artikujt e tekstilit (6.1 %), produktet bimore (4.8 %), plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (3.6 %), artikujt e gurit, llaçit, produktet e keramikës dhe të qelqit (3.2 %), produktet minerale (1.6 %), vajrat ushqyese (1.4 %), mjetet e transportit (0.5 %) dhe druri dhe artikujt e drurit (0.2 %).

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënja e çmimeve sipas sektoreve të këpucet (-13.5 %), lekura dhe artikujt e saj (-10.5%), letrat dhe artikujt e saj (-6.1 %), shtazet e gjalla; produktet e shtazëve (-2.7 %), artikujt e ndryshem të prodhuar (2.7 %), paisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (-2.5 %), artikujt ushqimor të përgaditur, pijet dhe duhani (-1.8 %), instrumentet optike, fotografik, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës (-1.4 %) dhe produktet e industrive kimike (-0.7 %).

Tabela 1:Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) TM1 2006–TM1 2018 (2010 = 100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje

Viti	Tremujori	Indeksi (2010 = 100)	Ndryshimi tremujor në përqindje	Ndryshimi vjetor në përqindje
2006	TM 1	86.2	:	:
	TM 2	88.7	2.9	:
	TM 3	89.1	0.5	:
	TM 4	87.7	-1.6	:
	Mesatarja vjetore 2006	87.9	:	:
2007	TM 1	89.4	1.9	3.7
	TM 2	92.1	3.1	3.9
	TM 3	91.1	-1.1	2.2
	TM 4	91.6	0.6	4.5
	Mesatarja vjetore 2007	91.1	:	3.6
2008	TM 1	95.0	3.6	6.3
	TM 2	100.9	6.2	9.5
	TM 3	102.5	1.6	12.5
	TM 4	96.9	-5.4	5.8
	Mesatarja vjetore 2008	98.8	:	8.5
2009	TM 1	93.7	-3.3	-1.3
	TM 2	94.2	0.5	-6.6
	TM 3	94.0	-0.2	-8.3
	TM 4	94.3	0.4	-2.7
	Mesatarja vjetore 2009	94.1	:	-4.8
2010	TM 1	95.7	1.5	2.1
	TM 2	99.0	3.4	5.1
	TM 3	101.4	2.5	7.9
	TM 4	103.9	2.5	10.2
	Mesatarja vjetore 2010	100.0	:	6.3
2011	TM 1	107.8	3.7	12.6
	TM 2	108.4	0.5	9.5
	TM 3	109.9	1.4	8.3
	TM 4	111.0	1.0	6.8
	Mesatarja vjetore 2011	109.3	:	9.3
2012	TM 1	113.9	2.6	5.6
	TM 2	114.9	0.9	6.0
	TM 3	115.4	0.5	5.0
	TM 4	115.8	0.3	4.3
	Mesatarja vjetore 2012	115.0	:	5.2
2013	TM 1	116.1	0.3	2.0
	TM 2	115.0	-1.0	0.1
	TM 3	114.8	-0.1	-0.5
	TM 4	114.8	0.0	-0.8
	Mesatarja vjetore 2013	115.2	:	0.2
2014	TM 1	115.5	0.6	-0.6
	TM 2	114.3	-1.0	-0.6
	TM 3	114.8	0.5	0.0
	TM 4	114.4	-0.4	-0.3
	Mesatarja vjetore 2014	114.7	:	-0.4

Tabela 1:Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP) TM1 2006–TM1 2018 (2010 = 100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje (vazhdim)

Viti	Tremujori	Indeksi (2010 = 100)	Ndryshimi tremujor në përqindje	Ndryshimi vjetor në përqindje
2015	TM 1	113.8	-0.5	-1.4
	TM 2	114.1	0.3	-0.2
	TM 3	113.9	-0.2	-0.8
	TM 4	111.8	-1.8	-2.3
	Mesatarja vjetore 2015	113.4	:	-1.2
2016	TM 1	108.8	-2.6	-4.4
	TM 2	109.6	0.7	-3.9
	TM 3	110.7	1.0	-2.8
	TM 4	113.2	2.2	1.3
	Mesatarja vjetore 2016	110.6	:	-2.5
2017	TM 1	114.4	1.1	5.2
	TM 2	114.3	-0.1	4.3
	TM 3	115.3	0.9	4.2
	TM 4	116.0	0.6	2.5
	Mesatarja vjetore 2017	115.0	:	4.0
2018	TM 1	116.0	0.0	1.4

Figura 1: Zhvillimi i IÇIMP, TM1 2006 – TM1 2018 (2010=100)




Tabela 2: Peshat, numrat e Indeksi, ndryshimet mujore dhe vjetore në përqindje sipas sektorëve të Sistemit të Harmonizuar

Kodi	Grupi	pesha	TM1 - 2018 2010 =100	TM1 - 2018 TM4 - 2017	TM1 - 2018 TM1 - 2017
01-21	IÇIMP - Gjithsej	1000	116.0	0.0	1.4
01	Shtazët e gjalla; produktet e shtazëve	38	122.1	-3.7	-2.7
02	Produktet bimore	50	180.2	-5.0	4.8
03	Vajrat ushqyese	10	154.3	-1.1	1.4
04	Artikuj ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhani	131	110.4	-0.8	-1.8
05	Produktet minerale	147	118.1	1.5	1.6
06	Produktet e industrive kimike	80	107.1	-0.6	-0.7
07	Plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre	64	115.9	2.6	3.6
08	Lëkura dhe artikujt e saj	2	97.2	-4.2	-10.5
09	Druri dhe artikujt e tij	26	124.4	-0.5	0.2
10	Letrat dhe artikujt e saj	16	102.0	0.1	-6.1
11	Tekstili dhe artikujt e tekstit	44	116.8	2.0	6.1
12	Këpucët	12	128.7	-13.0	-13.5
13	Artikujt e gurit, të llaçit, produktet e keramikës dhe te qelqit	34	112.2	1.2	3.2
14	Margaritarët, gurët e çmuar, metalet, etj.	:	:	:	:
15	Metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë	100	107.5	3.3	12.3
16	Paisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike	118	107.0	-0.9	-2.5
17	Mjetet e transportit	88	110.4	-0.3	0.5
18	Instrumentet optike, fotografik, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës	10	111.0	-0.8	-1.4
19	Armët dhe municioni	:	:	:	:
20	Artikujt e ndryshëm të prodhuar	28	113.7	0.1	-2.7
21	Veprat e artit	:	:	:	:

Metodologjia

Çmimet grumbullohen në bazë tremujore në 7 qendra regjionale të Kosovës: Gjakovë, Gjiilan Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj të cilat mbulojnë kompanitë më reprezentative të importit të cilat ishin aktive në shumicën e komunave.

Duke filluar nga tremujori i parë 2006, çmimet u grumbulluan në bazë tremujore për rreth 180 artikujt nga shtatëdhjetë kompani. Gjatë 2006 shumë vlerësime të reja të çmimeve u shtuan dhe për periudhën 2007-2008 numri i çmimeve të grumbulluara ishte rreth 250. Nga 2009 numri i çmimeve të grumbulluara ishte rreth 300, kurse nga viti 2015 numri i çmimeve është mbi 500 artikuj.

Rezultatet janë prezentuar sipas Sistemit të Harmonizuar të Organizatës Botërore të Doganeve (OBD).

Të dhënat e çmimeve janë grumbulluar për një mostër të transaksioneve tipike lidhur me mallrat e importuara në Kosovë

Mostrimi dhe kalkulimi i peshave

Mostra është projektuar nga të dhënat e tregëtisë së jashtme. Këto të dhëna janë përdorur gjithashtu edhe për kalkulimin e peshave specifike. Peshat janë bazuar në informatën nga të dhënat tregëtare V-1 (viti paraprak) dhe janë freskuar në bazë vjetore. Me anë të freskimit të peshave për çdo vit, shporta e IÇIM-së do të reflektojë ndryshimet në mostrat e tregëtisë. IÇIM-ja do të ndikohet nga të dyja ndryshimet e çmimeve dhe nga ndryshimet e strukture së importit

Variablët statistikor

Variabli kryesor është çmimi; ai mund të raportohet në çdo njësi monetare. Çmimet e raportuara në njësi të huaja monetare konvertohen në EURO. Njësia monetare e faturës dhe raportimit janë, prandaj si variabël plotësues. Kur çmimet raportohen në njësi të huaja monetare, atëherë përdoren tarifat e këmbimit të mesatarës tremujore të Bankës Qendrore Suedeze për konvertimin e tyre në EURO.

Formulat e indeksit

Indeksi i çmimeve të importit mund të përshkruhet si një indeks i llojit zinxhiror të Laspeyres-it me lidhje vjetore. Indeksi i Laspeyres-it definohet si në vijim.

$$I^t = \frac{\sum_{i=1}^n P_i^t Q_i^0}{\sum_{i=1}^n P_i^0 Q_i^0} = \sum_{i=1}^n \frac{P_i^0 Q_i^0}{\sum_{i=1}^n P_i^0 Q_i^0} \times \frac{P_i^t}{P_i^0}$$

Ku P^0 dhe P^t janë çmimet për njësi në periodën bazë (0) dhe perioda e krahasimit (t), përkatësisht, dhe Q^0 është sasia e periodës bazë. Mbledhja bëhet nëpërmes produkteve n. Në elementin qendror të mësipërm, indeksi shprehet me shkallën mes vlerës së mbledhur të shumave të periodës bazë në periodën e krahasimit dhe në nivelin e çmimit të periodës bazë, përkatësisht. Indeksi gjithashtu mund të shprehet, si në elementin final, si një mesatare e përafërt e çmimit të mallërave të peshuar me vlerat e periodës.

Çmimet e indeksit kalkuloohen me një tremujor aktual në vit si periudhë e krahasimit dhe me tremujorin e katërt në vitin **y-1** si period e references së çmimit. Perioda e peshimit është viti **y-1**. Në këtë mënyrë lidhja definohet si:

$$I_{y-1,q}^{y,q} = \frac{\sum_{s=1}^k V_s}{\sum_{s=1}^k V_s} \times \frac{P_s^{y,q}}{P_s^{y-1,q}}$$

Ku pasha e vlerës V_s është vlera e transakcioneve në vit e që përfaqësohen me specifikacionin **s**. Mbledhja bëhet nëpërmes specifikacioneve **k**.

Kalkulimi i indeksit zinxhiror të IÇIMP

Numri i indeksit zinxhiror kalkulohet për tremujorët dhe tregon nivelin e veçantë të çmimit të tremujorit krahasuar me nivelin e çmimit mesatar në 2010 (2010=100).

$$I_{2010}^{y,q} = \frac{100}{\frac{1}{4} \sum_{q=1}^4 I_{2009,q}^{2010,q}} \times \prod_{Y=2010}^{y-1} I_{Y-1,q}^{Y,q} \times I_{y-1,q}^{y,q}$$

Kalkulimi i ndryshimeve

Ndryshimi tremujor kalkulohet si:

$$\left[\left(\frac{IMPI_0^{Y,q}}{IMPI_0^{Y,q-1}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Ndryshim i përqindjes tremujore}$$

$IMPI_0^{Y,q}$ = Indeksi i çmimeve të importit për tremujorin aktual q

$IMPI_0^{Y,q-1}$ = Indeksi i çmimeve të importit për tremujorin e mëparshëm q-1

Ndryshimi vjetor kalkulohet si:

$$\left[\left(\frac{IMPI_{2010}^{Y,q}}{IMPI_{2010}^{Y-1,q}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Ndryshim i përqindjes vjetore}$$

$IMPI_{2010}^{Y,q}$ = Indeksi zinxhiror i çmimeve të importit për tremujorin aktual q

$IMPI_{2010}^{Y-1,q}$ = Indeksi zinxhiror i çmimeve të importit për vitin dhe për tremujorin paraprak q

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi më 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë *strukture organizative: Departamentet prodhuese; (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. Departamentet mbështetëse; (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale; Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj*

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 143 punëtorë, prej tyre, 98 (68,5%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 45 (31,5%), Agjencioni ka ketë strukture kualifikuese, 61,7% me shkollim universitar, 15,4 me shkollim të lartë, ndërsa 17,5% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë . Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- o **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- o **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- o **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- o **E-mail:** infoask@rks-qov.net
- o **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-qov.net>